



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assemble

Legjislatura V

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 02/2015

Prishtinë, më 13.01.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Sala Berisha-Shala, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Pal Lekaj - anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Fatmir Limaj dhe Duda Balje - anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ahmet Tmava - NSH “Trepça”; Burim Ejupi dhe Dardan Abazi – INDEP; Shefki Kastrati - NDI; Nehat Dervishi - OSBE; Nora Latifi-Jashari, Visar Rushiti dhe Berat Thaçi - GAP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.12.2014;
3. Shqyrtimi i Projektplanit të Punës së Komisionit;
4. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit më një njoftim urgjent të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP, të datës 12.01.2015, lidhur me vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. AC-1.-140247-A0001, i datës 09 janar 2015, lidhur me NSH “Trepça” dhe propozoi që të shtohet kjo pikë e rendit të ditës.

Me këtë propozim u pajtuan dhe anëtarët e Komisionit.

Rendi i ditës u miratua me futjen kësaj pike si pika e tretë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.12.2014;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 23.12.2014, u miratua pa vërejtje.

3. Njoftim urgjent i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP të datës 12.01.2015, lidhur me vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. AC-1.-140247-A0001 i datës 09 janar 2015, lidhur me NSH “Trepça”

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, tha që për këtë pikë të rendit të ditës ka ardhur për të na njoftuar në detaje z. Ahmet Tmava, drejtor i Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça”. Pastaj ia kaloi fjalën për të paraqitur opinionin e tij.

Ahmet Tmava, drejtor i Ndërmarrjes Shoqërore Trepça - Tha se Vendimi që ka ndërmarrë Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, rreth çështjes të Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça” nën administrimin e AKP-së” është një Vendim i dëmshëm për vetë ndërmarrjen dhe për gjithë punëtorët, pasi që Trepça deri më tani ka pasur të arritura dhe ka treguar një performancë të mirë në menaxhimin e resurseve nëntokësore. Vendim i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka ardhur si pasojë e mos kompletimit të Bordit të AKP-së. Ai theksoi se ndërmarrja “Trepça”, ndonëse në kushte jo të favorshme për punë, vitin e ka përmbysur me sukses, si në prodhim ashtu edhe në menaxhimin e resurseve të saja. Duke shprehur shqetësimin e tij, si dhe të punëtorëve (2000 sosh), të kësaj ndërmarrjeje, ai më tej shtoi se në Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjes, është paraparë që riorganizimi i ndërmarrjes të bëhet deri më dy prill. Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat ka funksionuar ndërmarrja, tha në vijim Tmava, ne jemi ankuar në Dhomën e Posaçme që ky afat të zgjatet. Dhoma e Posaçme, sqaroi ai, jo që nuk e ka zgjatur këtë afat, por e ka shkurtuar, nga dy prill në dy shkurt. Duke i bërë thirrje komisionit që të ndikojë në revidimin e vendimit të Dhomës së Posaçme, sipas të cilit pas datës dy shkurt, “Trepça” shkon në likuidim. Tmava në fund u shpreh:” Ndërmarrja shoqërore “Trepça”, është me interes nacional dhe duhet ruajtur me çdo kusht.

Kryetari tha se në të gjithë e dimë që ka qenë në proces në fund të mandatit të kaluar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, ku parashihej që të bëhet ristrukturimi i Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça” në ndërmarrje publike, por që ka mbetur pa u miratuar ky projektligj për shkak të shpërbërjes së Kuvendit. Theksoi se tani sipas procedurave Projektligji duhet fillojë prej fillimit procedurat, por që koha është shumë e shkurtër. Për këtë çështje tha që kemi një informatë nga Zyra e Kryeministrit që po e shqyrtojnë në Qeveri këtë çështje dhe shumë shpejt do ta njoftojnë Kuvendin, lidhur me vendimin që do të ndërmarrin. Tha që ka shumë kreditorë që pretendojnë që “Trepça” është e kreditorëve në qoftë që shkohet në bazë të kërkesës së kreditorëve dhe po ashtu edhe vetë ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve në të cilin është thirrur Gjykata është më shumë në favor të kreditorëve.

Raif Qela tha se këtë çështjen e Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça” e kam ngritur në mbledhjen e fundit, dhe tani koha është shumë e shkurtër, dhe është e udhës që ne, si Komision, të dalim më një qëndrim të përbashkët për këtë çështje. Theksoi se ky Vendim i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nëse realizohet do të jetë një humbje e madhe për ekonominë e vendit dhe vetë punëtorët e ndërmarrjes “Trepça”. Duke shtuar së kjo Dhomë e posaçme është një mbeturinë e UNMIK-ut, andaj institucionet tona duhet që sa më shpejt ta miratojnë Ligjin për Trepçën.

Visar Ymeri, tha se si Lëvizje Vetëvendosje e kemi kundërshtuar ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara në Legjislaturën e kaluar, sepse ka qenë kundër interesave të vendit, po në interes të kreditorëve. Tha që besoj së të gjitha grupet parlamentare do të pajtohen që ta ndalin këtë proces për Ndërmarrjen Shoqërore “Trepça” që mos ju lihet kreditorëve. Propozoi që Komisioni të hartojë një rekomandim për AKP-në dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës më njoftimin se jemi në proces të hartimit të Projektligjit për Trepçën, po ashtu të kërkohet edhe nga Qeveria që sa më shpejt të sjellë Projektligjin në Kuvend për miratim.

Fatmir Rexhepi tha se të gjitha partitë politike këtu kanë një dozë të fajit dhe Komisioni ka mundësi që të nxjerrë një rekomandim që sa ma shpejt më pasur veprime, sepse në bazë të vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është koha shumë e shkurtër, dhe të gjitha institucionet të bëjnë punën e vet që brenda afatit të dhënë të mbyllim më kohë këtë proces. Lidhur me këtë nga e kaluara kemi pasur plot pasoja më vendimet që janë ndërmarrë deri me tani, pasi që shumë çështje që kanë të bëjnë me ekonominë e vendit nuk janë trajtuar drejt, prandaj tani e tutje duhet t’i shqyrtojmë dhe analizojmë mirë çështje para së të marrim vendim për ekonominë e vendit.

Blerim Grainca, tha se vendim është politik dhe afati është shumë i shkurtër, dhe në duhet urgjentisht të marrim masa në parandalimin e këtij vendimi. Propozoi që kryetari të koordinojë punën më Qeverinë që sa ma shpejt të përshpejtohen procedurat për ta shfuqizuar këtë Vendim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Pal Lekaj tha se pajtohet më gjithë parafolësit se duhet të nxirret një rekomandim nga ana e Komisionit në mënyrë që të parandalohet ky Vendim kur dihet se gjithë çështja është politike. Theksoi se Vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës rreth çështjes të Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça” nën administrimin e AKP-së është absurd që kreditorët të kompensohen, kur dihet që 2 000 punëtorë mund të mbesin pa punë. Andaj edhe Qeveria në këtë rast dihet të ketë parasysh interesin ekonomisë vendore e posaçërisht të punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça”.

Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

1. Komisioni për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (në vijim Komisioni) ka shqyrtuar shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së me numër 142 datë 12 janar 2015, lidhur me Vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme më numër AC-I-14-0247-A0001 të datës 9 janar 2015;
2. Pas diskutimit Komisioni, me koncesus të plotë ka mbështetur masat që aktualisht janë duke u marrë në Qeveri dhe duke marrë parasysh urgjencën e kësaj çështje ka vendosur gjithashtu që të jetë mobil që në çdo kohë të zhvillojë aktivitetet përkatëse për tejkalimin e këtij problemi para datës 2 shkurt 2015. Në këtë aspekt Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës që me anë të procedurave adekuate të iniciojnë përfundimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për

Ndërmarrjet Publike dhe eventualisht nxjerrjes së akteve të tjera, për të evituar masat e paralajmëruara nga Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme që eventualisht do të mund të hynin në fuqi më datën 2 shkurt 2015.

3. *Në këtë drejtim Komisioni ka shprehur gatishmërinë që të jetë në dispozicion të institucioneve relevante që të zgjidhet kjo çështje sa më shpejt.*

4. Shqyrtimi i Projektplanit të Punës së Komisionit

Kryetari tha se në këtë pikë të rendit të ditës kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar për hartimin e Planit vjetor të komisionit për vitin 2015 për çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e Komisionit. Ai theksoi se stafi i Komisionit ka hartuar Projektplanin e Punës së Komisionit duke u bazuar në përgjegjësit dhe fushëveprimin që e ka Komisioni. Por që ende kanë mbetur disa çështje të hapura deri sa Qeveria të sjellë Strategjinë legjislative, ku duhet të përfshihet shqyrtimi i projektligjeve. Po ashtu në këtë Projektplanin të Punës së Komisionit janë të propozuar edhe disa ligj për mbikëqyrje. Theksoi se ne, si anëtarë të Komisionit Funksional, duhet t'i kemi në fokus primar 4-5 çështje që janë vitale dhe që kanë të bëjnë me zhvillimin përgjithshëm ekonomik të vendit siç janë: krijimi i mjedisit të favorshme për të bërë biznes, investimeve private të brendshme dhe të jashtme të ju krijohen kushte të volitshme për investim, krijohen kushte të përshtatshme për konkurrencën e lirë dhe të barabartë, të shikohet funksionimi i gjykatave në aspektin kontratave që po i zvarriten lendet e kompanive duke u marrë kohë të gjatë të shqyrtimit të lëndëve; prioritet në Planin e punës janë funksionimi i Ndërmarrjeve Publike dhe Agjencive të themeluara nga Kuvendi i Kosovës, duke i rishikuar kompetencat e bordeve, përbërjen e tyre së janë kompetente për punën që bëjnë, pavarësinë tyre, shqyrtimi i raporteve të tyre agjencive të bëhet duke shikuar performancën e tyre, dhe përmbushjen e përgjegjësisë që kanë me ligj, llogaridhënien dhe transparencën; në fund shtoi edhe çështje të tjetër, është dhe Raporti i Progresit i cili ka cekur sfidat e shumta për krijimin e një mjedisi më të mirë të bërit biznes, dhe shikojmë strategjitë e ministrive të linjës së sa po zbatohen, laboratorët dhe standardet në prodhim, zonat ekonomike, planin nacional për eficiencë etj. Pastaj, kërkoi nga deputetët që të paraqesin propozimet e tyre lidhur me Projektplanin të Punës së Komisionit.

Raif Qela tha se duhet ta mbikëqyrim Ligjin për ndërmarrjet publike, sepse ai parasheh që nëse Bordi i ndërmarrjes publike nuk ka performancë pozitive atëherë duhet shikuar shkarkimi i tyre dhe të ndërmarrin masa.

Besim Beqaj tha se ky është një plan i punës institucionale, por në duhet ta hartojmë një plan inovativ dhe të sjellim çështje inovative në plan. Për gjitha çështjet që u ngritën për mjedisin e të bërit biznes, për funksionimin e gjykatave kemi institucionet që merren më këto çështje, sa i përket krijimit të të bërit biznes, Ministria Tregtisë dhe Industrisë i ka disa aktivitet në kuadër të agjencisë brenda MTI-së. Por që duhet të ristrukturoar formën e tyre që të kalojë në nivel nacional për të pasur më shumë prioritet. Për funksionimin e gjykatave që kanë të bëjnë me kontekstet e kontratave të kompanive, tani kemi të licencuar përmbaruesit privat që duhet t'i zgjedhin këto konteste. Për ndërmarrjet publike tërthorazi kemi kompetenca, duke mbikëqyrë punën e Qeverisë mund të kemi raporte për funksionimin e tyre, ndërsa për Agjencitë e themeluara nga Kuvendi i Kosovës kemi kompetenca të drejtpërdrejta për mbikëqyrjen e punës së tyre me anë të ligjeve që janë themeluar. Në fund tha se duhet të merremi më çështjen e laboratorëve dhe më Komisionin e konkurrencës dhe ky institucion të aktivizohet.

Visar Ymeri tha se sa i përket ndërmarrjeve publike ne duhet ta rrisim rolin mbikëqyrës të Qeverisë, nëpërmes Njesisë për Monitorimin e ndërmarrjeve publike, për të na njoftuar më shpesh me raporte punë për funksionimin e ndërmarrjeve publike. Për investimet e huaja tha që nuk mund të kemi investimet huaja në këtë mënyrë, pra pa pasur rritje ekonomike prej së brendshmi,

fillimisht duhet të shikohen investimet prej së brendshmi duke rritur dhe përkrahur investimet prodhuese të brendshme, e pastaj krijohen hapësirat në treg që do të ndihmojnë ardhjen edhe investimeve të huaja, pra këtu ndaj qëndrim tha z. Ymeri. Ai shtoi se në Projektplanin e Komisionit kemi shumë propozime për monitorimin ligjeve dhe nuk dihet se a do të mbërrijmë t'i mbikëqyrim a jo, por me vendos se Komisioni duhet t'i ketë në fokus çështjet që kanë të bëjnë më energjinë elektrike ku kemi ngecur shumë dhe duhet t'i caktojmë disa prioritete në disa sektorë ku Kosova ka potencial për zhvillim në sektorin energjisë. Propozoi që në planin e punës ty hynë mbikëqyrja e ligjit për zyrën e rregullatorit të energjisë dhe ligji për energji, po ashtu propozoi që të mbikëqyren këto agjenci: Zyrën e Rregullatorit për Energji; Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe Autorin Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare.

Fatmir Rexhepi tha se sektorin privat prodhues industrial duhet ta promovojmë sa më shumë edhe në agjendën tonë dhe brenda planit të punës ta fusim si prioritet në mënyrë që të kemi një zhvillim më të fuqishëm ekonomik të vendit. Propozoi që Komisioni të kërkojë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ta rishikojë marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me Turqinë, pasi që kjo marrëveshje ka më qenë një sfidë e madhe për prodhuesit vendorë. Ai kërkoj të kërkohej nga MTI-ja një informatë më e detajuar së çka po ndodh më këtë marrëveshje.

Sala Berisha- Shala, tha se sot po diskutojmë vetëm një draft - plan pune që ende mund të futen edhe disa propozime, duhet të kërkohej nga Qeveria që sa më shpejt ta sjellë strategjinë legjislative pasi është rregull së të gjitha projektligjet mbetur në procedurë t'i kthehen Qeverisë. Pastaj, kur të kemi strategjinë legjislative kemi ma lehtë të shohim se cilat projektligje nuk i ka paraparë Qeveria në strategjinë legjislative mund t'i kemi në planin e punës vitin 2015 që komisioni t'i hartojë vetë ndonjë projektligj që është prioritet në zhvillimin ekonomik të shfrytëzimet të pasurive nëntokësore sikurse e patëm rastin me Trepçën. Po ashtu duhet të kemi sa më shumë mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve.

Besim Beqaj – propozoj që së parti të kemi raporte zyrtare nga institucionet përkatëse e mos të fusim në plan të punës çështje për trajtim që nuk janë objekt i fushëveprimit të Komisionit.

Blerim Grainca, propozoi që komisioni ta futë në planin e punës për vitin 2015 çështjen e rregullimit të tregut të naftës, pra të kemi iniciativë për këtë çështje, madje propozoj që menjëherë në muajt e parë ta shqyrtojmë këtë çështje.

Pal Lekaj tha se Projektplanin i Punës së Komisionit është shumë i qëlluar dhe pajtohem se prioritete të kemi monitorimin e ligjeve, agjencive, dhe të ndërmarrjeve publike. Theksoi se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë deri më tani nuk ka afruar kushte për investimet e huaja, andaj tani tutje duhet t' i japim prioritet më të madh krijimit të kushteve për investimet të huaja dhe përmirësimit të mjedisit biznesor.

Kryetari i Komisionit, **Muhamet Mustafa**, në fund përmbledhi pikat e diskutuara dhe idetë e shtruar nga ana e anëtarëve të Komisionit që të përfshihen në Planin e Punës për vitin 2015. Sipas Planit të Punës për këtë vit, Komisioni ka paraparë që ndër çështjet më me prioritet të trajtohet: krijimi i kushteve për një mjedis të përshtatshme të bërit biznes për investitorë të brendshëm dhe të jashtëm; stimulimi i prodhimeve vendore; krijimi i infrastrukturës ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve. Me theks të veçantë, do të mbikëqyret performanca e bordeve në ndërmarrjet publike, si dhe agjencitë e pavarura, të kërkohej raportimi i Ministrisë së Infrastrukturës për planin e ndërtimit të rrugëve. Këtë muaj të raportojë ministri i zhvillimit ekonomik, ndërsa në muajin shkurt të raportojnë dy ministrat e tjerë, ai i Tregtisë dhe Industrisë dhe i Infrastrukturës.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Kryetari dhe zëvendëskryetaret e Komisionit në bashkëpunim me stafin e Komisionit të hartojnë Planin e punës së Komisionit për vitin 2015, në bazë të propozimeve nga deputetët, brenda afatit prej 15 ditëve.

5. Te ndryshme;

Kryetari i Komisionit, **Muhamet Mustafa**, i njoftoi anëtarët e Komisionit se ka ardhur një ftesë për një vizitë në Turqi, nga Parlamenti Evropian në bashkëpunim me Kuvendin Kombëtar të Turqisë në Ankara, nga data 05-06 Shkurt 2015. Tema e këtij Seminari parlamentar është “Siguria e energjisë, energjia efëiente dhe ndërlidhja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”. Tha se duhet të caktohet një përbërje e delegacionit, nga katër deputetë dhe një zyrtar nga Komisioni.

Pas debatit Komisioni vendosi që, lidhur më pjesëmarrjen në seminarin “Siguria e energjisë, energjia efëiente dhe ndërlidhja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” – 5-6 shkurt 2015 që do të mbahet në Ankara, përbërja e delegacionit të Komisionit ka këtë përbërje: Muhamet Mustafa – kryetar; Visar Ymeri - zëvendëskryetar i parë; Sala Berisha-Shala dhe Pal Lekaj – anëtarë, nga stafi i Komisionit: Armend Ademaj – Koordinator.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit

Muhamet Mustafa